

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“ZHBLLOKIM ME BOT SONDE TË GROPAVE SEPTIKE DHE FURNIZIM ME BOT UJI”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 33141641-5
Sonde**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,400,000 (Dy milion e katërqind mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **UJESJELLES KANALIZIME KAMEZ SH.A.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma b) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit ndodhet ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, paraprafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit (480,000) leke dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licencat profesionale të vlefshme**, lidhur me ekzekutimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

- **III.2.B** Transportim i ujërave të zeza

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Operatori Ekonomik duhet të ketë dy liçencat profesionale të kërkuara për të vërtetuar që është i aftë për kryerjen e këtij shërbimi, pasi shërbimi që kërkohet ka të bëjë me heqjen, transportimin dhe magazinimin e mbetjeve që dalin nga pusetat e ujërave të zeza.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi /qera ose në përdorim kundrejt kontratës perkatese të noterizuar mjete transporti të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës si më poshtë:

- a) 2 (Dyë) autobot uji me kapacitet 8-12 m³ (shiko specifikimet teknike)
- b) 1 (Një) autobot me sonde teknologjike 5-7 m³ (shiko specifikimet teknike)
- c) 1 (Një) autobot me sonde teknologjike jo më pak se 12 m³ (shiko specifikimet teknike)
- d) 1 (Një) autobot thithës dhe mbajtes uji (shiko specifikimet teknike)

-Për Automjetet në përputhje me kodin rrugor të paraqiten:

Certifikate pronësie të mjetit

Siguracion I mjetit

Leje qarkullimi

Akt Kolaudimi

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Autobottet në pronësi ose më një kontratë qiramarrje të noterizuar për një periudhë jo më pak se 1 (një) vjeçare për të vërtetuar aftësinë e kryerjes së këtij shërbimi sipas nevojave të sektorit të ujërave të ndotura dhe ujit te pijshem brenda afatit 1 (një) vjeçar. Duhet të disponojë dëshmi për automjetin dhe pajisjet sipas Kodit Rrugor për të shmangur çdo parregullsi e cila do të bëhej shkak për mos kryerjen në kohë të shërbimit të kërkuar. Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të disponojë kokat e sondave sipas tabelave të mësipërme, të cilat kanë përmasa të ndryshme dhe përdoren sipas dimensioneve të tubacioneve të ujërave të ndotura si dhe per autobotet e ujit te pijshem te plotesojne te gjitha kriteret e cituara ne specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 5 shofer kamioni per te cilet duhet te paraqiten:

-Leja e drejtimit.

-Kopje kontrat-pune e vleshme per gjithe periudhen e realizimit te kontrates.

Shënim: Për pikat (2.3.2) dhe (2.3.3) më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime..

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar **5 (pese) shofer** të pajisur me leje drejtimi të posaçme, i cili do të bëj drejtimin dhe komandimin e autoboteve te kerkuar nga AK sipas nevojave qe ka Autoriteti Kontraktor.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në **Formularin Përmbledhës Të Vetëdeklarimit (Shtojca 9)**.*

Në çdo rast, përpara se të shpalle njoftimin e fituesit , Autoriteti Kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni I specifikimeve teknike, duke përcaktuar qartë kërkesat dhe standartet teknike për sa i përket shërbimit, objekt prokurimi.

Kërkesat janë specifikuar në menyrë të tillë pa krijuar pengesa në konkurrencën e lirë publike, duke mundësuar trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit.

Në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe [Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#)

NJESIA E PROKURIMIT

- 1.
- 2.
- 3.